

PLANI EKONOMIK LOKAL PËR  
KATEGORITË E CENUESHME TË  
QYTETARËVE, TË  
RIATDHESUARVE DHE  
ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË  
TYRE PËR KOMUNËN E TETOVËS

Ky publikim është përgatitur si pjesë e projektit “Rruga drejt rezistencës dhe riintegritit të familjeve të cenueshme në komunitet”, i cili zbatohet nga një konsorcium i organizatave: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar - MCMS, Nexus - Koncepti qytetar, Iniciativa për Perspektivë Evropiane - IEP , Horizon Civitas dhe Pleiades. Projekti mbështetet nga Fondi global i angazhimit dhe rezistencës së Komunitetit-GCERF.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e GCERF ose organizatave të tjera që e zbatojnë programin.

Autor: Goran Veleski

shkurt – prill 2022

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| Rezime.....   | 3  |
| Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Tetovës ..... | 5  |
| Të dhëna themelore për Komunën e Tetovës .....  | 6  |
| Nevoja, qëllimi dhe përdoruesit nga riintegrimi.....  | 9  |
| Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat.....  | 11 |
| Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës .....   | 11 |
| Orientimi në karrierë .....   | 12 |
| Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin.....   | 12 |
| Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore .....  | 13 |
| Vetëpunësimi .....  | 14 |
| Rekomandime .....   | 15 |

# Plani ekonomik lokal për kategoritë e cënueshme të qytetarëve duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre për Komunën e Tetovës

---

## Rezyme

Kthimi i të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre kërkon një qasje të ndjeshme në procesin e risocializimit, rehabilitimit dhe riintegritit sepse është një kategori veçanërisht e cënueshme e qytetarëve që ka nevojë për mbështetje nga një ekip multidisiplinar. Pas kthimit të të riatdhesuarve, vlerësimet e inteligjencës dhe hetimet policore janë parakushte për të përcaktuar rrezikun e mundshëm dhe nëse duhet të ketë ndjekje penale, kështu që disa prej tyre përfundojnë në burg, e disa mbeten të lirë për mungesë provash. Pas vuajtjes së dënimit ose në rast se i riatdhesuari shpallet i pafajshëm, vendoset nevoja e riintegritit të tij në shoqëri, pra në mjedisin ku jeton. Për këtë është e nevojshme të ndërmerren hapa për trajtimin individual të risocializimit edhe në burgje. Përveç të riatdhesuarit, duhet të punohet edhe me familjen e tij për të krijuar kushte për pranimin e tij, si parakusht për riintegritim të suksesshëm. Integritimi ekonomik është shumë i rëndësishëm, që i riatdhesuari të ndihet si një anëtar i dobishëm i komunitetit dhe shoqërisë. Domethënë të ndjesh se me punë të ndershme mund të jetohej në liri me dinjitet. Por që kjo të ndodhë, së pari duhet të forcohen kapacitetet e tyre përmes trajnimeve, rikualifikimeve, kurseve, vazhdimet të shkollimit e të ngjashme.

Riintegritimi është një proces përmes të cilit të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre fitojnë statusin e shtetësisë dhe fitojnë punësim dhe të ardhura të qëndrueshme<sup>1</sup>. Një nga kushtet për riintegritim të suksesshëm është trajtimi i punës, i cili duhet të zbatohet përmes planeve dhe masave të mirë-dizajnuara për riintegritimin ekonomik (të punës) me aktivizimin e tyre në tregun e punës, mbështetjen gjatë punësimit dhe ndjekjen dhe mbështetjen pas punësimit të tyre. Për të siguruar integritimin ekonomik të të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre, është e nevojshme të kryhen disa aktivitete si parakushte bazë për fillimin e procesit të integritit, si: sigurimi i dokumenteve personale, vlerësimi i gjendjes së përgjithshme shëndetësore, sigurimi i mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, fitimi i kushteve për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, strehim, ndihmë juridike, si dhe mbështetje psikologjike dhe socializim. Aktivitetet duhet të ofrohen para se të bëhet e mundur pjesëmarrja efektive në Politikat aktive të tregut të punës<sup>2</sup> dhe ato duhet të zbatohen para dhe paralelisht me procesin e aktivizimit të tregut të punës dhe punësimit.

---

<sup>1</sup> Integrated Disarmament, Demobilization and Reintegration standard (UN, 2006).

<sup>2</sup> <https://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nsp>

Subjektet afariste në Komunën e Tetovës janë më të shumtat në tregtinë me shumicë dhe pakicë, industrinë përpunuese, objektet akomoduese dhe shërbime ushqimore, ndërtimtari dhe aktivitete tjera shërbyese. Barrierat për zhvillimin e ndërmarrjeve janë qasja në financa dhe mospërputhja ndërmjet ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore. Për sa i përket mospërputhjes së fuqisë punëtore, nga intervistat me punëdhënësit shihet se nuk ka numër të mjaftueshëm të punëtorëve në ndërtimtari dhe bujqësi. Gjithashtu, ka një deficit të fuqisë punëtore adekuate në turizëm dhe hoteleri, pasi theksohet veçanërisht deficitin e kamerierëve dhe kuzhinierëve.

Zhvillimi rural dhe zhvillimi i turizmit mbeten të pashfrytëzuara për shkak të mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar, shfrytëzimit të pamjaftueshëm të qendrave dimërore dhe rekreative, infrastrukturës së dobët rurale dhe rrugore, mosekzistencës së qendrave të zhvillimit të turizmit rural etj. Në atë drejtim është e nevojshme të vepohet për të tërhequr investime në zhvillimin e turizmit në zonat rurale. Zhvillimi i turizmit në Komunën e Tetovës përfshin zhvillimin e turizmit dimëror, zhvillimin e zonave të mbrojtura, zhvillimin e turizmit alternativ, promovimin e mbrojtjes së mjedisit etj.<sup>3</sup> Bujqësia, ndërtimtaria, turizmi dhe hoteleria në Komunën e Tetovës paraqesin sektorë ekonomikë që kanë kërkesë të vazhdueshme në tregun e punës, gjë që paraqet mundësi për kategoritë e cënueshme të qytetarëve që të punësohen. Duke pasur parasysh se nuk ka fuqi punëtore adekuate sipas kërkesës, trajnimi në vendin e punës dhe punësimi i subvencionuar përmes subvencionimit të pagave paraqet një mundësi adekuate për ta.

Problem i madh për aktivizimin e kategorive të cënueshme të qytetarëve në tregun e punës është se ata mësohen të jetojnë me ndihmën sociale që marrin nga shteti. Pjesa më e madhe e tyre kanë borxhe të papaguara për të cilat ekziston rreziku i përmbarimit, kështu që nëse krijojnë marrëdhënie pune, një pjesë e pagës së tyre do të shkojë për arkëtimin e borxheve. Prandaj vendosin të punojnë “në të zezë” dhe të marrin ndihmë nga shteti. Mundësitë për integrim të mëtejshëm ekonomik përfshijnë: identifikimin e sfidave me të cilat përballen në tregun e punës, orientimin në karrierë, forcimin e kualifikimeve dhe aftësive në lidhje me punësimin, punësimin e subvencionuar dhe trajnimin në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore, dhe/ose vetëpunësimi.

---

<sup>3</sup> Plani strategjik për periudhën strategjike 2021 - 2024

## Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Tetovës

Plani ekonomik për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në shoqëri në Komunën e Tetovës është përgatitur duke mbledhur, organizuar dhe sintetizuar në mënyrë sistematike informacionet në dispozicion.

Hulumtimi kishte për qëllim kuptimin e kontekstit në vend në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe prioritetet dhe tendencat e riintegritit ekonomik të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Po aq e rëndësishme, u identifikuan gjithashtu boshllëqet me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre që duhet të adresohen gjatë riintegritit të mëtejshëm ekonomik.

Aktivitetet përfshijnë analizën e literaturës ekzistuese, analizë e të dhënave dytësore dhe krijimin e një liste referimi në mënyrë që të gjitha dokumentet të jenë të organizuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

Analiza e literaturës ekzistuese relevante për riintegrimin ekonomik përfshin një rishikim të rregulloreve ekzistuese, dokumenteve strategjike, planeve të veprimit dhe operacionale, raporteve për zbatim, teksteve gazetareske, etj. Gjithashtu u rishikua literatura shkencore nga praktikantët në shtetet e tjera dhe komunitetet lokale që përballen me këtë problem.

Pas shqyrtimit të literaturës ekzistuese, filloi analiza e të dhënave të disponueshme publike, si të dhëna demografike, ekonomike, sociale, të dhëna arsimore, si dhe të dhëna nga tregu i punës. Të dhënat janë përdorur për të perceptuar situatën dhe për të propozuar politika/masa për riintegrimin ekonomik, të bëra në bazë të të dhënave të disponueshme.

Gjatë përgatitjes së Planit ekonomik për riintegrim në nivel lokal, janë marrë njohuritë nga drafti i hulumtimit për nevojat e tregut të punës për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre, i cili është realizuar në tranzicionin para përgatitjes së planeve ekonomike.

## Të dhëna themelore për Komunën e Tetovës

Komuna e Tetovës shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë, në Luginën e Pollogut të Poshtëm dhe paraqet një mjedis multietnik, ku shumica e popullsisë janë të nacionalitetit shqiptar.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave nga viti 2019, numri i banorëve në komunën e Tetovës është 92.946. Ka një tendencë emigrimi, veçanërisht të rinjve, të cilët si fuqi punëtore e arsimuar, largohen nga qyteti dhe vendi drejt vendeve të tjera evropiane dhe botës.

Ekonomia e Komunës së Tetovës ka një vend të rëndësishëm në ekonominë e Republikës së Maqedonisë. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, ritmi i rritjes së bruto prodhimit të brendshëm në vitin 2017 ishte 1,1% dhe ishte më i ulëti në pesë vitet e fundit. Në vitin 2018, bruto prodhimi i brendshëm u rrit me 2.9%, ndërsa në vitin 2019 ritmi i rritjes ishte 3.2%. Për shkak të krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, në vitin 2020 u regjistrua një rënie prej -12,7%.

Sa i përket gjendjes ekonomike në Komunën e Tetovës, është evidente se shtytës i zhvillimit ekonomik të komunës janë bizneset mikro dhe të vogla, të cilat përbëjnë 98,7% të numrit të përgjithshëm të subjekteve aktive në Komunën e Tetovës. Megjithatë, në periudhën e kaluar një tendencë e dukshme është mbyllja e subjekteve aktive mikro dhe të vogla, ristrukturimi i vazhdueshëm i subjekteve afariste dhe hapja e subjekteve të reja. Kjo situatë ndikon negativisht në stabilitetin e punësimit dhe shkakton pasiguri në tregun e punës.

Bartës të zhvillimit ekonomik të Komunës së Tetovës janë industria ushqimore, tregtia me shumicë dhe pakicë, industria e ndërtimitarisë dhe ajo e tekstitit. Përveç këtyre industrive, zhvillimin e Komunës së Tetovës e mundëson edhe tregtia, hoteleria dhe shërbimet zeytare.

Subjektet afariste janë më aktive në tregtinë me shumicë dhe pakicë, shërbimin e automjeteve, industrinë përpunuese dhe catering.

Qasja në burime financiare, mungesa e besimit në marrëdhëniet e biznesit, etika e pamjaftueshme e punës së fuqisë punëtore dhe fuqia punëtore e arsimuar joadekuate janë theksuar si faktorë kufizues të mundësive të biznesit të subjekteve afariste.

Në aspektin arsimor, Komuna e Tetovës karakterizohet me një rrjet arsimor shumë të zhvilluar. Në komunë funksionojnë 22 shkolla të rregullta fillore dhe 7 shkolla të mesme. Shkollat e mesme janë të profileve të ndryshme: dy gjimnaze, mjekësi, ekonomi, bujqësi, tekstile dhe muzikë. Në Tetovë funksionojnë dy universitete: Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Evropës Juglindore.

Në kuadër të komunës janë ndërmarrë aktivitete për përshtatjen e ofertës së fuqisë punëtore të arsimuar dhe të kualifikuar me nevojat e subjekteve afariste, të cilat duhet të realizohen në vazhdimësi për rritjen e punësimit në nivel lokal.

Sipas Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal, sektori i biznesit nuk është i gatshëm të krijojë partneritete financiare me qëllim të trajnimit të stafit dhe as të pranojë studentë si praktikantë, të dhënat që tregojnë se bashkëpunimi ndërmjet sektorit të biznesit dhe institucioneve arsimore nuk është i zhvilluar sa duhet.<sup>4</sup>

Papunësia e lartë është një problem i madh, por edhe një sfidë për komunën. Sipas të dhënave të Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, numri i të papunëve në Komunën e Tetovës me 31 janar 2021 është 15.603 persona, kështu që Komuna e Tetovës është në vendin e dytë sipas numrit të personave të papunë pas Qytetit të Shkupit. Numri i punëkërkuesve aktivë sipas grup moshave rritet me rritjen e moshës (në grup moshën 55-59 vjeç është 2135), gjë që tregon se një numër i madh i të papunëve regjistrohen në Qendrën e punësimit si punëkërkues aktivë për të siguruar mbështetje sociale, e siguruar përmes ndihmës minimale të garantuar.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale krijon masa dhe programe aktive për uljen e papunësisë, masa të cilat ofrojnë lehtësim, mbështetje dhe inkurajim për personat e papunë me fokus të rinjtë, gratë dhe personat e marginalizuar, si dhe masa për mbështetjen e ndërmarrjeve. Në kuadër të këtyre masave ofrohen donacione financiare, lehtësime financiare, trajnime etj. Ato realizohen përmes Qendrës për punësim në Tetovë. Një nga masat më domethënëse është garancia për të rinjtë, përmes së cilës lehtësohet kalimi i të rinjve nga arsimi në punësim, përmes mbështetjes për gjetjen e një vendi pune në gjashtë muajt e parë pas përfundimit të arsimit. Plani për zbatimin e Garancisë për të rinjtë përmban masa për forcimin e sistemit të arsimit të mesëm profesional, masa për identifikimin e të rinjve që nuk janë as të punësuar, as në proces arsimimi apo trajnimi, si dhe masa për integrimin e të rinjve. Objektivi i masës Garancia për të rinjtë është që rreth 30% e të rinjve që regjistrohen për herë të parë si punëkërkues aktivë të marrin oferta për punësim, trajnim apo praktikë.

Këshilli lokal ekonomik dhe social që funksionon në kuadër të komunës, përmes miratimit të planeve lokale të veprimit për punësim, avokon për promovimin dhe zhvillimin e tregut cilësor dhe konkurrues në rajonin e Tetovës, promovimin dhe zhvillimin e arsimit dhe aftësimin sipas nevojat e tregut të punës (formal dhe informal) dhe krijimi i një mjedisi të favorshëm për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Këshilli gjithashtu mori pjesë aktive në përafrimin e programit të shkollave të mesme profesionale me kërkesën për fuqi punëtore. Me iniciativën e Këshillit u organizuan edhe kurse për parukierë, rrobaqepës, saldatorë dhe profesione të tjera.

---

<sup>4</sup> Draft – Plani strategjik i Komunës së Tetovës 2021-2024 , tetor 2020



Kurset i kanë vizituar rreth 200 persona dhe një pjesë e madhe e tyre janë punësuar në Tetovë, por edhe në vendet e Lindjes së Mesme, ku profesioni i saldatorit ishte veçanërisht i kërkuar.

Për t'i ndihmuar gratë që t'i bashkohen tregut të punës dhe të punësohen, Këshilli lokal ekonomik dhe social po ofron ndihmë dhe mbështetje nga donatorët për të hapur 10 qendra për zhvillimin e fëmijërisë së hershme. Funksionimi i qendrave për zhvillimin e fëmijërisë së hershme përmes kujdesit ndaj fëmijëve, u jep grave mundësinë për t'u bashkuar me tregun e punës dhe për të gjetur një punë.

Bashkëpunimi ndërmjet komunitetit lokal dhe sektorit të biznesit është krijuar përmes aktiviteteve për promovimin e ndërmarrjeve, për të cilat është vendosur çmimi për ndërmarrjet me përgjegjësi shoqërore. Duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e përgjegjësisë sociale të ndërmarrjeve, hapen mundësi punësimi për kategoritë e cenueshme të tregut të punës, përfshirë të riatdhesuarit dhe familjarët e tyre.

## Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre

Procesi i realizimit të risocializimit, rehabilitimit dhe riintegritit të personalitetit të të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre bazohet në respektimin e parimeve të mëposhtme: njohja e çdo personi; angazhimi i vazhdueshëm i personit; respekt dhe besim; përfshirja aktive dhe vullnetare e personit në trajtimin e tij; zhvillimi i tipareve dhe aftësive pozitive të karakterit për kthim të shpejtë dhe të suksesshëm në shoqëri; sistematizim, shpejtësi dhe unitet në zbatimin e trajtimit.

Riintegrimi si koncept nënkupton një sërë aktiviteteve sistematike që kryhen për riintegrimin në shoqëri të individit, i cili për disa arsye është marginalizuar prej saj. Për këtë qëllim, zhvillohen programe specifike që përfshijnë mbështetje terapeutike dhe psikologjike, ofrimin e arsimit, formimin profesional, punësimin, sportin dhe ushtrimet fizike, aksesin në aktivitete kulturore, shëndetin dhe kujdesin dhe promovimin e marrëdhënieve shoqërore. Programe të tilla zbatohen përmes mentorimit social, i cili synon të ndryshojë perceptimet për nevojat e të riatdhesuarve.

Gjatë trajtimit të këtyre personave vëmendje e veçantë i kushtohet: edukimit dhe formimit profesional, parandalimit shëndetësor dhe edukimit shëndetësor, krijimit të shprehive të punës, zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë ndaj vetes, personave të tjerë dhe kërkesave sociale, organizimit të kohës së lirë në formë sporti - aktivitete rekreative dhe kreative, kontakte me familjarë ose kujdestarë ligjorë, kontakte pozitive sociale me botën e jashtme.

### Nevoja, qëllimi dhe përdoruesit nga riintegrimi

Në përputhje me nevojat dhe sfidat me të cilat po përballen shoqëria jonë, pas ardhjes së të riatdhesuarve, është evidente nevoja për një qasje holistike në lidhje me integrimin e tyre në shoqëri. Vetëm një qasje e përbashkët, veprime sistematike dhe vullneti për bashkëpunim i të gjitha subjekteve shoqërore të përfshira mund të prodhojë rezultatet e dëshiruara. Veprimi sistematik imponon domosdoshmërisht nevojën e përgatitjes së një Plani dhe Programi për integrimin e të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre, i cili do të parashikojë në detaje aktivitete që duhet të ndërmerren për të realizuar me sukses procesin e planifikuar.

Për t'iu qasur riintegritit ekonomik është i nevojshëm zbatimi i disa komponentëve të planit të riintegritit, si parakushte të rëndësishme që personi të arsimohet dhe të konkurrojë në tregun e punës, gjegjësisht:

- Sigurimi i një lehtësie për akomodim afatgjatë për personat që nuk kanë vendbanim
- Ndihmë dhe mbështetje për lëshimin e dokumenteve personale (përfshirë dokumentacionin mjekësor)
- Aktivizimi i sistemit të kujdesit shëndetësor, ofrimi i kujdesit shëndetësor dhe mbikëqyrja shëndetësore nëpërmjet ekzaminimeve shëndetësore dhe diagnostike.

- Ofrimi i ndihmës juridike falas, informacioni për të drejtat dhe detyrimet e personave.
- Krijimi i profileve personale dhe vlerësimi i riskut, këshillim psikologjik nga psikologë të trajnuar, të cilët do të jenë në gjendje të komunikojnë me njerëzit. Zhvillimi i planeve individuale për riintegrimin e të riatdhesuarve.

Në kuadër të këtij projekti janë planifikuar masa dhe aktivitete me të cilat do të menaxhohet me sukses procesi integrues dhe ky dokument do të japë një pasqyrë të veçantë të masave dhe aktiviteteve që duhet të zbatohen në drejtim të integrimit ekonomik, gjegjësisht përfshirjes aktive të grupeve të synuara në tregu i punës. Dokumenti do të përfshijë gjithashtu kualifikimet dhe aftësitë arsimore që duhet të fitojnë të riatdhesuarit dhe familjarët e tyre, si një parakusht i rëndësishëm për gjetjen e punësimit, por edhe për integrim të suksesshëm.

## Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat

Qëllimi strategjik i planit të riintegritit ekonomik është ofrimi i mundësive për punësim dhe të ardhura të denjë për kategoritë e cënueshme të qytetarëve, si dhe për të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Në Tetovë janë duke u zbatuar masa dhe programe që ndihmojnë aktivizimin e grupeve të cënueshme në tregun e punës, para së gjithash përmes Qendrës për punësim në Tetovë. Ata mund të përfitojnë nga flukset e kërkesës për punë dhe me zhvillimin e duhur profesional të punësohen.

Aktorët kryesorë në integrimin ekonomik të të riatdhesuarve dhe familjeve të tyre në nivel lokal janë: Komuna e Tetovës, Qendra për punësim-Tetovë, ndërmarrjet lokale me përgjegjësi shoqërore, organizatat lokale qytetare me mision social (ndërmarrjet sociale), ofruesit vendorë të trajnimeve të certifikuara për të rritur, Qendra për punë sociale-Tetovë dhe shkollat e mesme profesionale në nivel lokal.

Plani ekonomik për integrim i parasheh masat e mëposhtme:

### Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës

Një nga aktivitetet e para gjatë integritit ekonomik duhet të jetë aktivizimi i tregut të punës. Një numër i madh i të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre nuk kanë informacion të mjaftueshëm për mundësitë për zhvillim profesional dhe punësim në ekonominë lokale të Komunës së Tetovës. Kjo paraqet një nga barrierat më të rëndësishme për integrimin e tyre ekonomik. Për punësimin e tyre më të lehtë, duhet të identifikohen zbrazëtitat ndërmjet kualifikimeve dhe aftësive të tyre dhe kualifikimeve dhe shkathtësive që kërkohen në tregun e punës nga punëdhënësit vendor në territorin e Komunës së Tetovës. Identifikimi i barrierave në tregun e punës duhet të bëhet nga këshilltari i karrierës.

Në drejtim të punësimit të tyre të denjë, përballen me disa pengesa si: mungesa e arsimit adekuat, mungesa e përvojës në punë, kujdesi për anëtarët e familjes, gjendja e keqe financiare, puna joformale, qasja e kufizuar në arsim, mbështetja e kufizuar shëndetësore dhe sociale, mospasja e informacionit të mjaftueshëm për mundësitë, stigmatizimi, mungesa e mundësive të jetesës, dekurajimi etj.

## Orientimi në karrierë

Orientimi në karrierë<sup>5</sup> është një shërbim që lidhet ngushtë me planet individuale të zhvillimit, i cili duhet të ndihmojë kategoritë e cenueshme në tregun e punës për të menaxhuar karrierën e tyre, për të bërë zgjedhjen e duhur në arsim, trajnim dhe mbi të gjitha në zgjedhjen e profesionit të përshtatshëm. Gjithashtu do t'i ndihmojë ata të përputhen me ambicjet, interesat, kualifikimet, aftësitë dhe talentet e tyre me mundësitë në tregun e punës. Orientimi në karrierë përfshin disa aktivitete të ndërlidhura:

- Orientimi në arsim dhe informacione për karrierën,
- Këshillim individual dhe në grup,
- Vlerësimi i aftësive dhe vlerësimi psikometrik,
- Asistencë në kërkimin e një pune dhe ndërmjetësim në punësim me punëdhënësit,
- Orientimi për zhvillimin e aftësive të nevojshme për kërkimin e punës dhe vetëpunësimin.

Orientimi efektiv në karrierë i ndihmon individët të arrijnë potencialin e tyre, të bëhen më të fortë ekonomikisht dhe të integrohen më lehtë në shoqëri.<sup>6</sup> Orientimi në karrierë nuk duhet të ndalen me punësimin e personave, duke pasur parasysh se ata mund të jenë sërish të papunë.

Këshilltarët për karrierë duhet të jenë persona me reputacion dhe besim në bashkësinë lokale (komuna e Tetovës), ata duhet të inkurajojnë të kthyerit dhe anëtarët e familjeve të tyre që të aktivizohen në tregun e punës dhe të punësohen.<sup>7</sup>

Këshilltarët për karrierë duhet të jenë persona me reputacion dhe besim në komunitetin lokal (Komuna e Tetovës), ata duhet të inkurajojnë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre që të aktivizohen në tregun e punës dhe të punësohen.

## Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin

Një nga barrierat për zhvillimin ekonomik të ndërmarrjeve në Komunën e Tetovës është fuqia punëtore joadekuate. Trajnimi është mënyra e vetme për të kapërcyer këtë pengesë. Trajnimet synojnë të përmirësojnë aftësitë dhe kualifikimet e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre për integrimin më të suksesshëm të tyre në tregun e punës. Për njerëzit që kanë aftësi të pamjaftueshme për tregun e punës, trajnimi luan një rol kyç në sigurimin e punësimit afatgjatë.<sup>8</sup>

---

<sup>5</sup> Në disa vende termat si “këshillim për karrierën”, “zhvillimi i karrierës”, “informacion për karrierën, këshilla dhe udhëzime”, “këshillim profesional” ose “udhëzim profesional” i referohen gamës së aktiviteteve të përfshira këtu brenda nocionit të orientimit në karrierë.

<sup>6</sup> Investing in career guidance, revised edition 2021 – CEDEFOP.

<sup>7</sup> Një vit pas punësimit është një periudhë e mirë për të ndjekur personin në karrierën e tij.

<sup>8</sup> Vocational Education and Training (VET) and Adult Learning, OECD 2022.

Trajnimet për plotësimin e profesioneve të kërkuara në tregun e punës nga zbatues të verifikuar të trajnimit (trajnime profesionale) i referohen profesioneve që do të rezultojnë të jenë të kërkuara nga punëdhënësit. Ato kryhen nga ofruesit e verifikuar të trajnimit (shkollat e mesme profesionale, ndërmarrjet private, odat ekonomike, odat e artizanatit, etj.). Në rajonin e Komunës së Tetovës ekzistojnë 29 ofrues të verifikuar të trajnimeve, të cilët ofrojnë kualifikime në fusha të ndryshme. Llojet e trajnimeve në nivel lokal në të cilat këta persona mund të marrin pjesë dhe të fitojnë kualifikimet e nevojshme mund të shihen në faqen e Qendrës së Arsimit të Rriturve në linkun e mëposhtëm [Lista e programeve – TIS \(cov.gov.mk\)](https://cov.gov.mk).

Duke pasur parasysh se në territorin e Komunës së Tetovës ka një deficit të punëtorëve të ndërtimtarisë, bujqësisë dhe punëtorëve në turizëm dhe hotelieri, është e nevojshme të zhvillohen trajnime/kurse dhe të rritet ndjeshëm punësimi në tregun e punës.

Krahas trajnimeve për plotësimin e profesioneve të kërkuara në tregun e punës me ofrues të verifikuar trajnimi, ka edhe lloje të tjera trajnimesh, si: trajnime në vendin e punës për një punëdhënësit të njohur, trajnime online, trajnime për zhvillimin e aftësive digjitale, praktikë, trajnime për gjuhë të huaja etj. Ato paraqesin një mundësi të mirë punësimi, kryesisht për personat që kanë aftësi të kërkuara nga punëdhënësit. Pjesëmarrja e të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre në këto trajnime në kuadër të Komunës së Tetovës varet para së gjithash nga barrierat e identifikuar në tregun e punës me të cilat ballafaqohen ata në nivel individual, si dhe nga interesimi i punëdhënësve.

Trajnimi në vendin e punës mund të jetë një mundësi e mirë duke pasur parasysh se punëdhënësit nga Komuna e Tetovës janë të interesuar të marrin pjesë në këtë lloj masash. Këto trajnime realizohen nga Agjencia për punësim, përmes Qendrës për punësim në Tetovë. Këto trajnime nuk rezultojnë me një diplomë kualifikimi, por vlerësimi i ndikimit në punësueshmërinë e këtij lloj trajnimi tregon sukses të madh në shkallën e punësueshmërisë në nivel lokal.

Aktualisht janë dy trajnime të verifikuara për aftësi në territorin e Komunës së Tetovës, të cilat mund t'i shikoni në ueb-faqen e Qendrës për arsim ose në linkun e mëposhtëm [Lista e programeve – TIS \(cov.gov.mk\)](https://cov.gov.mk)

### **Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore**

Një hap në rrugën drejt integritit në tregun e punës mund të jetë punësimi i subvencionuar ose ndonjë lloj tjetër mbështetjeje që mbështet ekonominë sociale (p.sh. organizatat e shoqërisë civile me mision social dhe/ose ndërmarrjet sociale<sup>9</sup>). Në mënyrë që integrimi përmes ndërmarrjes sociale të jetë efektiv, duhet të ofrohet trajnim dhe mentorim me punësimin e subvencionuar, me qëllim të integritit afatgjatë në tregun primar të punës. Punësimi i

---

<sup>9</sup> Gjatë përgatitjes së aktiviteteve për definimin e ndërmarrjes sociale në Maqedoni.

subvencionuar është masë aktive në Planin operativ për masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, i cili zbatohet nga Agjencia për punësim, përmes Qendrës për punësim Tetovë.

Kjo masë paraqet një nga masat më atraktive të punësimit për punëdhënësit nga Komuna e Tetovës. Ai synon gjithashtu të ndihmojë njerëzit që janë më të largët nga punësimi i denjë.

Komuna e Tetovës ka përvojë në zbatimin e një shpërblimi për ndërmarrjet me përgjegjësi shoqërore, të cilat mund të kontaktohen edhe si punëdhënës potencial të këtyre personave. Bashkëpunimi i Komunës së Tetovës me odat ekonomike (kryesisht Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore) mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm në aspektin e hartës së ndërmarrjeve me përgjegjësi shoqërore.

Bashkëpunimi me sektorin e shoqërisë civile dhe hartëzimi i organizatave të shoqërisë civile mund të jetë hapi i parë në krijimin e një infrastrukture për aktivizim dhe punësim. Lista e organizatave civile në nivel të Komunës së Tetovës mund të gjendet përmes ueb-faqes së Regjistrimit qendror në linkun në vijim [Sistemi për regjistrim të centralizuar të përdoruesve – Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut \(crm.com.mk\)](http://crm.com.mk).

### Vetëpunësimi

Qëllimi kryesor i masës është të mbështesë të papunët në krijimin e kompanisë së tyre, duke formalizuar një aktivitet tashmë ekzistues (joformal), përmes granteve për pajisje dhe materiale. Qëllimi i drejtpërdrejtë është krijimi i subjekteve juridike (mikro-bizneset) me hapjen e vendeve të reja të punës, duke stimuluar kërkesën në tregun e punës me vetëpunësim. Pjesëmarrësit në këtë masë i nënshtrohen trajnimit prej 30 orësh për ndërmarrësi dhe përgatisin një ide biznesi. Kandidatët më të mirë marrin ndihmë shtesë këshilluese për zhvillimin e një plani biznesi. Pas përfundimit të planit të biznesit bëhet një renditje nga një komision ekspertësh dhe kandidatët më të mirë marrin fonde të pakthyeshme për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve për fillimin e biznesit.

Masa e vetëpunësimit mund të paraqesë një mundësi të mirë për të hyrë në kapital, në rast se personi ka aftësi mikro-biznesi (p.sh. zejtar). Mbështetja financiare në materiale dhe pajisje arrin në rreth 5,000 euro. Trajnimet dhe këshillimet për ndërmarrësinë që ndihmojnë në krijimin e një plani biznesi janë të një rëndësie të madhe për suksesin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve.

Pjesëmarrja në këtë masë kërkon kujdes, para së gjithash duke pasur parasysh detyrimet që marrin përsipër personat që do të përfitojnë grant, sepse zakonisht bizneset e vogla janë të cenueshme.

Kjo masë është pjesë e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, i cili zbatohet nga Agjencia e punësimit në bashkëpunim me Agjencinë për zhvillimin e ndërmarrësisë. Shpallja për pjesëmarrje në masë publikohet një ose dy herë në vit.

## Rekomandime

1. Punëdhënësit në territorin e Komunës së Tetovës ballafaqohen me fuqi punëtore joadekuate dhe mungesë. Sektorët më të zakonshëm ku ka kërkesë për punë për të cilët nuk mund të gjenden punëtorë me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme janë ndërtimtaria, bujqësia, hoteleria dhe prodhimi. Trajnimi në punë i kategorive të cënueshme të qytetarëve mund të rrisë ndjeshëm punësueshmërinë e tyre.
2. Aktivizimi i tregut të punës duhet të bëhet nga këshilltarët e karrierës. Këshilltarët e karrierës duhet të krijojnë besim me njerëzit me të cilët punojnë, veçanërisht me të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Këshilltarët e karrierës në nivel vendor mund të jenë profesionistë në profesionin e tyre, por mbi të gjitha duhet të jenë persona që mund të fitojnë besimin e të kthyerve dhe familjarëve të tyre. Një nga aktivitetet në procesin e integritit ekonomik duhet të jetë hartëzimi i këshilltarëve të mundshëm për karrierë nga bashkësia lokale (Komuna e Tetovës).
3. Qëllimi strategjik i punësimit të tyre dhe sigurimit të të ardhurave do të arrihet përmes një qasjeje holistike në shërbimet dhe masat për aktivizimin e tregut të punës, si: identifikimi i barrierave në tregun e punës, këshillimi dhe siguri i informacionit për karrierën, udhëzimi drejt arsimit formal dhe joformal, trajnimi në klasë dhe/ose në vendin e punës, zhvillimi i aftësive për kërkimin e punës, asistenca për kërkimin e punës, punësimi i subvencionuar dhe vetëpunësimi. Një pjesë e masave të nevojshme realizohen përmes Qendrës për punësim në Tetovë.
4. Trajnimet luajnë një rol kyç në sigurimin e punësimit më të mirë afatgjatë në mesin e personave që nuk kanë aftësi adekuate në tregun e punës. Kombinimi i tyre me punësim të subvencionuar ose vetëpunësim mund të çojë në punësim të denjë për të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Këto masa janë tërheqëse për punëdhënësit nga Komuna e Tetovës dhe paraqesin një mundësi të fortë për integrimin ekonomik të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.
5. Për zbatimin e masave është e nevojshme të vendoset bashkëpunim efektiv ndërmjet Komunës së Tetovës, organizatave të shoqërisë civile me mision social, ndërmarrjeve lokale me përgjegjësi shoqërore, Qendrës për punësim në Tetovë, Qendrës për punë sociale në Tetovë, shkollave të mesme profesionale lokale dhe ofruesit e arsimit të të rriturve.